РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

ДКСК
ДРЖАВНА КОМИСИЈА ЗА СПРЕЧУВАЊЕ НА КОРУПЦИЈАТА
KSHPK
KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

08-1095/2
15-02.2023

Drejtuar

____________________________________

Lënda: Njoftim për krijimin e regjistrit të ri për personat e zgjedhur dhe të emëruar

Të nderuar,

Ju informojmë se Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit ka krijuar një Regjistër të ri elektronik për personat e zgjedhur dhe të emëruar, i cili do të fillojë të funksionojë nga data 15.02.2023, ku forma, përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së të cilit janë të përcaktuara me Rregulloren për përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit për personat e zgjedhur dhe të emëruar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr.33/2023), e publikuar në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror.

Nga data e caktuar, 15.02.2023, udhëheqësit e institucioneve/organeve (apo personat e autorizuar prej tyre) janë të obliguar që të japin të dhënat për personat e zgjedhur/emëruar gjegjësisht personat nga neni 82 paragrafi (1) të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konflikteve të interesave, në mënyrë elektronike t'i plotësojnë në formularin e dhënë, nga ku të dhënat shkarkohen në regjistër.

Forma dhe përmbajtja e formularit është e përcaktuar me Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e Formularit të të dhënave për personat e zgjedhur dhe të emëruar ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 33/2023), e publikuar edhe në veb faqen e Komisioni Shtetëror.

Për të shpjeguar procedurën për plotësimin e të dhënave për personat e zgjedhur dhe të emëruar, është hartuar një udhëzues për përdoruesit, të cilin mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm: https://dksk.mk/mk/upatstvo-za-ir/

Për më tepër, ju rikujtojmë detyrimin e përcaktuar në nenin 91 paragrafi (1) të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konflikteve të Interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë) nr.12/2019, ku është përcaktuar se:

*„Personat udhëheqës në institucionet dhe organet që kryejnë zgjedhjet dhe emërimet ose personat e autorizuar prej tyre kanë për detyrë që të dhënat për personat nga neni 82 paragrafi (1) të këtij ligji me plotësimin e formularit t'i dorëzojnë te Komisioni Shtetëror pa prolongim, më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e verifikimit të mandatit, zgjedhjes dhe emërimit, si dhe pas ndërprerjes së funksionit, përkatësisht detyrës së personit të zgjedhur ose të emëruar"*

Mospërmbushja e detyrimit nga neni 91 paragrafi (5) nënkupton zbatimin e nenit 112 të ligjit, sipas të cilit:

*„Gjobë në shumë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit udhëheqës të institucionit përkatësisht organit i cili kryen zgjedhje dhe emërime ose personit të autorizuar nga ai i cili në Komisionin Shtetëror pa prolongim, e më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e verifikimit të mandatit, zgjedhjes dhe emërimit, si dhe pas pushimit të funksionit, përkatësisht detyrës së personit të zgjedhur dhe emëruar nuk do t'i dorëzojë formular të plotësuar me të dhënat për personat nga neni 82 paragrafi (1) të këtij ligji (neni 91) ".*

Vërejtje: Institucionet/organet të cilët nuk e kanë përmbushur rregullisht detyrimin për futjen e të dhënave për personat e zgjedhur/emëruar gjatë zgjedhjes, emërimit apo ndërprerjes së funksionit, është e nevojshme që të dhënat për ata persona të futen në Regjistrin e ri të personave të zgjedhur dhe të emëruar, jo më vonë se 01.04.2023.

Me respekt,

**KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
**ZËVENDËSKRYETAR**
**Katica Nikolovska**

Përgatiti: I.B
Përktheu: A.A

РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

ДКСК KSHPK
ДРЖАВНА КОМИСИЈА ЗА СПРЕЧУВАЊЕ НА КОРУПЦИЈАТА
KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Drejtuar

______________________

Lënda: Njoftim për krijimin e regjistrit të ri për personat e zgjedhur dhe të emëruar

Të nderuar,

Ju informojmë se Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit ka krijuar një Regjistër të ri elektronik për personat e zgjedhur dhe të emëruar, i cili do të fillojë të funksionojë nga data 15.02.2023, ku forma, përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së të cilit janë të përcaktuara me Rregulloren për përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit për personat e zgjedhur dhe të emëruar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.33/2023), e publikuar në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror.

Nga data e caktuar, 15.02.2023, udhëheqësit e institucioneve/organeve (apo personat e autorizuar prej tyre) janë të obliguar që të japin të dhënat për personat e zgjedhur/emëruar gjegjësisht personat nga neni 82 paragrafi (1) të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konflikteve të interesave, në mënyrë elektronike t'i plotësojnë në formularin e dhënë, nga ku të dhënat shkarkohen në regjistër.

Forma dhe përmbajtja e formularit është e përcaktuar me Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e Formularit të të dhënave për personat e zgjedhur dhe të emëruar ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 33/2023), e publikuar edhe në veb faqen e Komisioni Shtetëror.

Për të shpjeguar procedurën për plotësimin e të dhënave për personat e zgjedhur dhe të emëruar, është hartuar një udhëzues për përdoruesit, të cilin mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm: https://dksk.mk/mk/upatstvo-za-ir/

Për më tepër, ju rikujtojmë detyrimin e përcaktuar në nenin 91 paragrafi (1) të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konflikteve të Interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë) nr.12/2019, ku është përcaktuar se:

*„Personat udhëheqës në institucionet dhe organet që kryejnë zgjedhjet dhe emërimet ose personat e autorizuar prej tyre kanë për detyrë që të dhënat për personat nga neni 82 paragrafi (1) të këtij ligji me plotësimin e formularit t'i dorëzojnë te Komisioni Shtetëror pa prolongim, më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e verifikimit të mandatit, zgjedhjes dhe emërimit, si dhe pas ndërprerjes së funksionit, përkatësisht detyrës së personit të zgjedhur ose të emëruar"*.

Mospërmbushja e detyrimit nga neni 91 paragrafi (5) nënkupton zbatimin e nenit 112 të ligjit, sipas të cilit:

*„Gjobë në shumë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit udhëheqës të institucionit përkatësisht organit i cili kryen zgjedhje dhe emërime ose personit të autorizuar nga ai i cili në Komisionin Shtetëror pa prolongim, e më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e verifikimit të mandatit, zgjedhjes dhe emërimit, si dhe pas pushimit të funksionit, përkatësisht detyrës së personit të zgjedhur dhe emëruar nuk do t'i dorëzojë formular të plotësuar me të dhënat për personat nga neni 82 paragrafi (1) të këtij ligji (neni 91) "*.

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија
Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut
email: contact@dksk.org.mk
тел/tel: +389 2 3248 930
https://www.dksk.mk

ДКСК KSHPK

ДРЖАВНА КОМИСИЈА ЗА СПРЕЧУВАЊЕ НА КОРУПЦИЈАТА

KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Vërejtje: Institucionet/organet të cilët nuk e kanë përmbushur rregullisht detyrimin për futjen e të dhënave për personat e zgjedhur/emëruar gjatë zgjedhjes, emërimit apo ndërprerjes së funksionit, është e nevojshme që të dhënat për ata persona të futen në Regjistrin e ri të personave të zgjedhur dhe të emëruar, jo më vonë se 01.04.2023.

Me respekt,

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
ZËVENDËSKRYETAR
Katica Nikolovska

Përgatiti: I.B
Përktheu: A.A